

Data 08.05.2026

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME
(PROCEDURË E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajta e sistemit te karikimit të makinave EV”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 98390000-3 - Shërbime të tjera.

VLERA E FONDIT LIMIT: 16,600,000 (Gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind mijë) Lek pa TVSH ose 173,931 (Njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 08/05/2026 është 95.44 Lekë/Euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare , KESH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sa më sipër.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Ligj Nr. 29/2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar), VENDIM Nr. 211, datë 9.4.2025 PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 922, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DEKLARIMIN E DETYRUESHËM TË DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE”, UDHËZIM Nr. 24, datë 6.11.2025 PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM NR. 26, DATË 8.9.2023, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit, brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Për Autoritetin Kontraktor KESH sh.a, plotësimi i këtij kriteri është i rëndësishëm pasi shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara në sektorin publik apo sektorin privat janë kushte të nevojshme që garantojnë se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të mëparshme të ngjashme vërtetojnë se zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses këtë procedure prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata ose ekuivalente të tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- SSH ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës SSH ISO 9001 ose ekuivalentit të saj është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me natyrën e shërbimit objekt prokurimi, i cili përfshin mirëmbajtjen dhe mbështetjen teknike të sistemit të karikimit të automjeteve elektrike (EV), ku garantimi i cilësisë, qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së shërbimit është element thelbësor.

Certifikimi ISO 9001 dëshmon se operatori ekonomik aplikon një sistem të strukturuar të menaxhimit të cilësisë, i cili siguron kontroll të proceseve, menaxhim të risqeve, përdorim efektiv të burimeve dhe përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve të ofruara.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose distributor i autorizuar ku të vërtetohet lidhje me prodhuesin për shitjen e shërbimit të garancise ose suportit të pajisjeve, dhe të licensave të përfshira në listen e suporteve. Autorizimi duhet të leshohet nga prodhuesi i sistemit ose distributori i autorizuar për zerat: (1) Sistemi qendror për menaxhimin e karikuesve elektrike (Platforma Cosmos **ose ekuivalent**).

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të shërbimeve të kërkuara. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter teknik është vendosur në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), Nr.1101/2024.

2.3.4 Ofertuesi duhet të jetë i licencuar nga prodhuesi i sistemit ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, për ofrimin e mirëmbajtjes dhe suportit teknik për pajisjet e karikimit elektrik, sipas termave të referencës.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paqesë licensën përkatëse të kompanisë.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e licensës nga prodhuesi i sistemit për ofrimin e mirëmbajtjes dhe suportit teknik është një dokument i rëndësishëm, për llojin e shërbimit të kërkuar në këtë kontratë, pasi na garanton se ofertuesi është i licencuar për këtë shërbim. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.5 Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij minimalisht personelin e mëposhtëm:

- 2 (dy) specialistë të certifikuar për zgjidhjet teknike dhe mirëmbajtjen e karikuesve elektrikë (EV Charger).

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

✚ Kontratë pune të vlefshme;

✚ Certifikata e mësipërme e vlefshme.

✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig për periudhën Shkurt 2026-Prill 2026.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, pikës 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet, që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Ky kriter është vendosur në përputhje me termat e referencës, ku është kërkuar kryerja e mirëmbajtjeve periodike të karikuesve elektrik në mënyrë që të vazhdohet ofrimi i shërbimit të karikimit të makinave hibride që KESH posedon.

Kontrasti dhe zëvendësimi i pjesëve të dëmtuara/jashtë funksioni si pasojë e mos kryerjes së mirëmbajtjeve në dy vitet e fundit.Licencimi i platformës së menaxhimit.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i termave të referencës :

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:

Referuar nevojës për mirëmbajtjen e karikuesve elektrik të instaluar në pikat e godinave të KESH si edhe licencimi i sistemit të menaxhimit të pajisjeve të karikimit, që do kryejë monitorim dhe komandimin e karikuesve në kohë reale, e cila gjeneron raporte të ndryshme sipas nevojës mbi gjithë sistemin për karikimin e automjeteve të cilat janë në pronësi dhe përdorim të KESH sh.a. Platforma e menaxhimit të karikuesve në përdorim është platforma Cosmos. Suporti dhe licensimi i ofruar duhet t’i shërbejë këtij sistemi.

Aktualisht KESH sh.a ka në përdorim automjete të cilat e kanë të nevojshme shërbimin e karikimit.Korporata Elektroenergjitike sh.a. ka të instaluar 4 (katër) karikues elektrik Fast Charger, përkatësisht:

- Fast Charger model Raption 100 me fuqi 100 KW/h, në zyrat qendrorë në Tiranë;
- Fast Charger model Raption 50 me fuqi 50 KW/h, pranë Hec Vau i Dejës;
- Fast Charger model Raption 50 me fuqi 50 KW/h, pranë Hec Koman;
- Fast Charger model Raption 50 me fuqi 50 KW/h, pranë Hec Fierzë.

Njësia e Prokurimit